

**AKT THEMELIMI**  
**i Shoqërisë "CROWN" Sh.p.k.**

Sot, më datë 20/03/2023,

- **Z. Gojart Bilal Laçi**, shtetas shqiptar, lindur me 19/04/1974, ne Tirane, mbajtes i dokumentit me nr. personal H40419125U, madhor e me zotesi te plote juridike e per te vepruar;

Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", kanë vendosur të themelojnë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "CROWN" Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria").

**NENI 1**

**EMËRTIMI**

Emri i Shoqërisë është "CROWN" Sh.p.k.

**NENI 2**

**SELIA**

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: Bulevardi Shqipëria e re, Zyra Nr.2, shkalla 16, ap.296, kati i III, Tiranë.

Shoqëria mund të çelë degë dhe/ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë, si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër.

**NENI 3**

**KOHËZGJATJA**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asamblesë së Ortakëve.

**NENI 4**

**OBJEKTI**

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë:

- Aktivitet ne fushen e ndertimit. Punime te specializuara ne ndertim.
- Konsulence per strategji marketingu, studim tregu, menaxhim produkti dhe materialesh ndertimi dhe cdo fushe veprimtarie, gjetje furnitoresh per produkte IT dhe Ndertimi.
- Ne fushen e ndertimeve, ndertimeve civile dhe ekonomike,ndertime publike dhe bujqesore e fetare, ndertime vepra arti, ndertime ujsjellesa dhe kanalizime rikonstruksionesh godina civile dhe ekonomike,veshje fasadash,mirembajtje,zhvillimi i dekorit ne mjedise urbane,
- Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to, rifiniture me infrastrukture druri, infrast, metalik dhe xhami dhe rifiniture te natyres teknike ndertuese, Impiate te sinjalistikes ndricuese, Sinjalistika rrugore jo ndricuese, barriera dhe mbrojtje rrugore, ndertime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri, punime strukturore speciale, Shtresa dhe mbistruktura 2 infrastrukture, punime mbi shina dhe traversa.



- Pastrimi ujerave detare, liqenore dhe lumore, Ndertim i impiateve te ujit te pijshem dhe pastrimit te tij, Ndertim i impiateve te grumbullimit dhe trajtimit te mbetjeve urbane. Punime topogjeodezike, Sistemet kundra zhurmes per infrastrukture, Shpime gjeologo-inxhinier, puse e shpime per uje, Grumbullimi dhe transportimi i mbetjeve inerte, urbane, dherave, e te tjera te kesaj natyre.
- Sherbime pastrimi dhe mirembajtjeje te ambienteve te brendshme dhe te jashtme, industriale dhe civile, publike dhe private, reklamave e totemeve te ambienteve spitalore, qendrave shendetesore, qendrave tregtare, hoteleve, zyrave, universiteteve, marketeve, bankave, bar-restoranteve, porteve, aeroporteve, terminaleve etj.
- Transport, grumbullim dhe evadim te mbetjeve urbane, pastrim i hapësirave te qyteteve, fshatrave etj. dhe trajtimi e riciklimi i mbetjeve.
- Ne tregtim te mallrave te ndryshme me shumice dhe pakice,eksport dhe importimin e tyre, tregetim te prodhime bujqesore e blegtorale dhe perpunim te tyre. Hapje hotelesh restorante e bar-bufe,supermarkato, transport i mallrave dhe i udhetareve brenda dhe jashte vendit, hapje agjensi turistike dhe gjithcka qe eshte e lejuar nga ligji. Tregtim me shumice e pakice te paisjeve kompjuterike, import-eksport i paisjeve te ndryshme kompjuterike dhe elektronike, keshillim ne lidhje me paisjet kompjuterike, krijim te bazes se te dhenave etj. Rrjete te telekomunikacionit, rrjete transmetimi si edhe rrjete te telefonise se levizshme te formes celulare ose te çdo forme.
- Importimi/Eksportimi e tregtimi i sistemeve per perpunimin e te dhenave te te gjitha llojeve si: hardware, software dhe te gjitha paisjeve periferike, montimin, parametrizimi, konfigurim etj. Mirembajtje, suport teknik, konsulence, integrimi, implementimi dhe operimi te paisjeve elektronike te siperpermendura. Pjesemarrjen ne tendera te te gjitha llojeve, te zhvilluara nga Shteti, Entitete Ligjore publike ose private, te huaja dhe vendase, perdoruesve Publik dhe çdo Organizate, {Corporate Publike dhe individesh ne pergjithesi me qellimin per te marre persiper punimet e mesiperme si kontraktor ashtu edhe si nen-kontraktor.

Shoqëria mund të kryejë gjithashtu të gjitha operacionet tregtare, mbi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, operacione financiare, industriale, që do të vlerësohen të nevojshme apo të dobishme për realizimin e objektit të shoqërisë si dhe të blejë pjesëmarrje në kapitalin themeltar të shoqërive të tjera që kanë objekt të njëjtë, të ngjashëm apo që lidhet me të vetin. Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomike.

## **NENI 5**

### **KAPITALI THEMELTAR**

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributi në të holla i Ortakut themelues në vlerën 100 Lekë (njqind lekë) dhe është i përbërë nga një kuotë.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

- **Z. Gojart Bilal Laçi**, zotëron 1 kuotë, me 100% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 100 Lekë (njqind lekë) dhe 100 Lekë (njqind lekë) të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

## **NENI 6**

### **ORGANET E SHOQËRISË**

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.
- Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori/ët. Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë.

**Z. Gojart Bilal Laçi**, shtetas shqiptar, lindur 19/04/1974, ne Tirane, mbajtes i dokumentit me nr. personal H40419125U, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, zgjidhet si Administrator për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

## **NENI 7**

### **LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM**

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

## **NENI 8**

### **DISPOZITA FINALE**

Ky Akt Themelimi hartohet në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Përmbajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortaku themelues i shoqërisë, duke autorizuar **Administratorin Z. Gojart Laçi** për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë.

**ORTAKU THEMELUES  
GOJART LAÇI**

